

KËRKESË
Nr. 457/10, datë 12.6.2025

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga realizimi i projektit ‘Leje rikonstruksioni e ndërtesës së dëmtuar, pa shtim apo ndryshim volumi, për projektin ‘Përforcimi i pallatit 1300’”, Bashkia Vlorë.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Bashkia Vlorë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit “truall”, bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë” dhe llojit “ndërtesë”, bazuar VKM-në nr. 138, datë 23.2.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, për pasuritë e llojit “ndërtesë banimi ose jobanimi”, i ndryshuar, sipas tabelës bashkëlidhur.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Vlorë, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 5 533 752 (pesë milionë e pesëqind e tridhjetë e tre mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e dy) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Kastriot Gurra

LISTA EMËRORE “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, TË CILËT PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT ‘LEJE RIKONSTRUKSIONI E NDËRTESES SË DËMTUAR, PA SHTIM APO NDRYSHIM VOLUMI, PËR PROJEKTIN ‘PËRFORCIMI I PALLATIT 1300’”, BASHKIA VLORE

Nr.	Pronari	ZK	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Volum	Faqe	Truall m ²	Ndërtesë m ²	Adresa	Sipërfaqe truallit për shpronësim	Çmimi i truallit lekë/m ²	Vlera e truallit lekë	Sipërfaqe ndërtimi për shpronësim	Çmimi i ndërtimit lekë/m ²	Vlera e ndërtimit lekë	Vlera e truallit dhe ndërtesës	Shënime
1	Mujsi Delo Lamaj	8604	19/237/1	truall	72	197	50	50	Vlorë	50	6,899.00	344,950.00					Ndërtesa është njësi shërbimi dhe vlera është llogaritur me situacion punimesh. Objekti është i pandarë në fakt, ndaj është përlogaritur një situacion për të gjithë ndërtesën.
			19/237/2	truall	72	198	50	50	Vlorë	50	6,899.00	344,950.00			4,843,852.00	5,533,752.00	
	Totali											689,900.00			4,843,852.00	5,533,752.00	